

MEMORANDUMI I MIRËKUPTIMIT

Memorandum i mirëkuptimit mbi çështjet sociale në kontekstin e Komunitetit të Energjisë

Republika e Shqipërisë, Bosnja dhe Hercegovina, Republika e Kroacisë, ish Republika Jugosllave e Maqedonise, Republika e Malit të Zi, Republika e Serbisë, Misioni i Përkohshëm Administratës i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) në pajtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, dhe Komuniteti Evropian,

Duke marrë parasysh dhe duke ndërtuar mbi Memorandumet e Athinës 2002 dhe 2003 për tregjet rajonale të energjisë në Evropën Juglindore dhe integrimin e tyre në tregun e brendshëm të energjisë të Komunitetit Evropian ('Procesi i Athinës');

Duke marrë parasysh Traktatin për krijimin e Komunitetit të Energjisë ('Komuniteti i Energjisë'), i nënshkruar më 25 Tetor 2005 i cili konsolidon 'Procesin e Athinës'

Duke marrë parasysh themelimin brenda BE-së të tregut të brendshëm të Energjisë, në bazë të Direktivave për tregun e brendshëm 2003/54¹ dhe 2003/55²;

Duke marrë parasysh dimensionin social të tregut të brendshëm të Komunitetit Evropian;

Duke marrë parasysh parimet, të cilët janë shpalosur në procesin e Stabilizimit dhe Asociimit, e bashkëpunimit midis BE-së dhe vendeve të rajonit, si dhe domosdoshmërinë e bashkëpunimit midis vendeve të rajonit;

Duke marrë parasysh të drejtat themelore sociale ashtu siç ato i garanton Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, Karta Sociale Evropiane, Karta e Komunitetit mbi të Drejtat Themelore Sociale të Punëtorëve si dhe të drejtat sociale të shpalosura në Kartën e shpallur të BE-së mbi të drejtat themelore;

Duke marrë parasysh standardet bazike të punës, siç përcaktohen nga Deklarata e Organizatës Ndërkombëtare e Punës mbi Parimet dhe të Drejtat Themelore në punë e adoptuar në vitin 1998³, promovimi i të cilave është pjesë integrale e promovimit nga Komuniteti i punës së mirë;

Duke njohur nevojën për ndërtimin e dimensionit social në Komunitetin e Energjisë, përfshirë trajtimin e barabartë të meshkujve dhe femrave, me qëllim të promovimit të progresit ekonomik dhe social, përmirësimit të standardeve të jetës, mirëqenies në punë

¹ DIREKTIVA 2003/54/EC E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT TË 26 Qershorit 2003 në lidhje me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë dhe shfuqizimin e Direktivës 96/92/EC

² DIREKTIVA 2003/55/EC E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT TË 26 Qershorit 2003 në lidhje me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror dhe shfuqizimin e Direktivës 98/30/EC

³ Deklarata e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP) mbi Parimet dhe të drejtat themelore adoptuar në seksionin e 86, Gjenevë, Qershor 1998

dhe përmirësimit të kushteve të punës në Komunitetin e Energjisë përfshirë trajtimin e barabartë të meshkujve dhe femrave;

Duke njohur nevojën për t'i ndihmuar ndërmarrjet dhe punëtorët të parashikojnë, përshtatin dhe menaxhojnë pozitivisht ndryshimet socio-ekonomike që mund të ndodhin nga implementimi i Traktatit për krijimin e Komunitetit të Energjisë;

Duke njohur rëndësinë dhe kontributin e dialogut social në të gjitha nivelet, në mënyrë që të parashikohen dhe menaxhohen pasojat sociale që rrjedhin nga implementimi i Traktatit për krijimin e Komunitetit të Energjisë;

Duke njohur nevojën për ofrimin e shërbimeve të cilësisë së lartë, të arritshme dhe të përbalueshme, që i plotësojnë nevojat e qytetarëve dhe ndërmarrjeve si dhe për promovimin e interesave të konsumatorëve; duke marrë parasysh situatën specifike në secilin Pale, meqë ekziston nevoja për tarifa që reflektojnë kostot,

Duke njohur rëndësinë e bashkëpunimit të përforcuar në politikat kompatible horizontale, relevante për implementimin e Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Duke njohur nevojën për sigurimin e një pranimi të gjerë nga publiku të Komunitetit të Energjisë dhe për përfshirjen e partnerëve relevantë nga shoqëria civile, përfshirë këtu konsumatorët, sindikatat dhe punëdhënësit në implementimin dhe monitorimin e tij;

Duke njohur kontributin e madh të anëtareve të grupit koordinues të Donatorëve⁴ në krijimin e kushteve që lejojnë arritjen e synimeve të këtij Memorandumi;

Vendosen ti përkushtojnë përpjekjet e tyre më të mira për të arritur sa vijon:

1. FUSHËVEPRIMI I MEMORANDUMIT

Ky memorandum bën të ditur synimin politik të Palëve për të dhënë rëndësinë e duhur dimensionin social brenda kontekstit të Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Nënshkruesit shënojnë që zhvillimi ekonomik dhe progresi social përkrahin njeri tjetrin dhe duhet të shkojnë krah për krah. Nënkuptohej që një reforma e suksesshme e tregut të energjisë do të risë eficiencën e tregut dhe do të kontribuojnë në përmirësimin e kushteve të jetës dhe punës të njerëzve. Nënshkruesit njohin nevojën e monitorimit të kushteve të punës dhe ndikimit social dhe në punësim nga implementimi i Traktatit për themelimin të Komunitetit të Energjisë. Paralelisht, nënshkruesit njohin nevojën që pasojat kryesore sociale të implementimit të këtij Traktati duhet të konsiderohen e ballafaqohen poashtu.

Ky Memorandum njih rëndësinë e dimensionit social dhe tregon parimet dhe kontekstin për një dialog social në sektorin e energjisë në të dyja nivelet, atë kombëtarë dhe rajonal. Nënshkruesit do të ndihmojnë dhe promovojnë dialog social efektiv në sektorin e energjisë.

⁴ Siç është vendosur në Konferencën e Stambollit të Paktit të Stabilitetit në Shtator 2004

2. OBLIGIMET E SHËRBIMIT PUBLIK

Nënshkruesit do të përpiqen për të zhvilluar nivelet më të larta të mundshme të mbrojtjes sociale për konsumatorët në pajtim kjo me një treg të qëndrueshëm dhe konkurrues dhe, kur paraqitet nevoja të zbatojnë masa mbrojtëse që kufizojnë ndikimin e ndryshimeve sociale dhe ekonomike në pjesë të veçanta të shoqërisë, në përputhje këto me obligimet e Traktatit për themelimin e Komunitetit të Energjisë .

Ashtu siç e kërkon Traktati për themelimin e Komunitetit të Energjisë, secili Nënshkrues do të zbatojë Nenin 3 të Direktivës 2003/54 EC dhe Nenin 3 të Direktivës 2003/55 EC me vëmendje të posaçme në mbrojtjen me përparësi të interesave të konsumatorëve më vulnerabil. Në realizimin e kësaj, Nënshkruesit do të përpiqen të sigurojnë kohezion ekonomik, social dhe territorial, qasje universale, dhe një nivel të lartë të të drejtave të konsumatorëve, të krahasueshme këto me ato që janë dhënë nga Shtetet Anëtare dhe Unioni Evropian.

Nga Komisioni Evropian ftohet të zhvillojë strategjitë për t'u ballafaquar me dimensionin social në gjerësi duke mbuluar çështjet e afordibilitetit, varfërisë energjetike, reformës për ngrohjen qendrore, distribuimin rural, sistemet e izoluar, dhe ndikimeve sociale të reformave.

3. PARTNERËT SOCIAL

Nënshkruesit vërejnë që adresimi i ndikimeve të mundshme sociale të Komunitetit të Energjisë kërkon qeverisje efektive të procesit duke përfshirë angazhimin dhe pjesëmarrjen e aktorëve të ndryshëm, në veçanti të partnerëve social në nivel kombëtar. Për këtë, ata e njohin nevojën e angazhimit të partnerëve social në të gjitha nivelet e përshtatshme duke promovuar dialogun social në lidhje me monitorimin e implementimit të Komunitetit të Energjisë dhe efekteve të tij. Kjo i referohet veçanërisht, por jo vetëm, hapjes së tregut, rritjes së konkurrencës dhe ristrukturimit. Kështu, secili Nënshkrues duhet të aplikojë mekanizma efektive për informim dhe konsultim të partnereve social për secilën nga këto çështje.

4. MENAXHIMI I NDRYSHIMIT

Nënshkruesit vërejnë që Komuniteti i Energjisë dhe procesi i hapjes së tregjeve të energjisë elektrike dhe energjisë së gazit ofron mundësi të reja ekonomike dhe të punësimit. Megjithatë në ndërkohë, ai mund të shpie në ristrukturimin dhe ndryshimin e ndërmarrjeve dhe punonjësit e tyre, që fillimisht do të prekte punëtorët me kualifikim të ulët dhe grupet vulnerable të punëtorëve ose zonat e përqendruara gjeografikisht.

Në mënyrë që të adresohen sfidat e tranzicionit në periudhën afatshkurtër, vëmendje e veçante do t'i kushtohet parashikimit dhe menaxhimit të pasojave sociale që rrjedhin nga implementimi i Traktatit për themelimin e Komunitetit të Energjisë.

Kështu, Nënshkruesit duhet të synojnë përmirësimin e adaptueshmërinë e punëtorëve, veçanërisht të atyre me kualifikim të ulët, dhe/apo punëtorëve të moshuar, duke mbështetur investimet në kapitalin njerëzor dhe mësimin përgjatë tërë jetës në përputhje me nevojat vendore, duke promovuar zhvillimin e shërbimeve mbështetëse specifike të punësimit dhe trajnimit.

5. DIMENSIONI SOCIAL

Bazuar në parimin e dialogut me partnerët social dhe në dispozitat ekzistuese të Unionit Evropian, Nënshkruesit konsiderojnë rëndësinë e përqendrimit të vëmendjes së tyre, brenda fushëveprimit të këtij Memorandumi, në këto fusha kyçe:

- Të drejtat themelore të punëtorëve sipas Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave Njerëzore dhe Lirive Themelore, Kartën Sociale Evropiane, Kartën e Komunitetit për të Drejtat Themelore Sociale të Punëtorëve dhe Kartën e BE-së mbi të Drejtat Themelore;
- Ligjet e punës – në lidhje me promovimin e kushteve të përmirësuara të punës dhe të standardeve të jetës;
- Shëndeti dhe siguria në punë – në lidhje me përmirësimet në mjedisin e punës sa i përket shëndetit dhe sigurisë së punëtorëve në sektorin e energjisë;
- Mundësitë e barabarta – me fokus në zbatimin, ku të jetë e nevojshme, të parimit që mashkulli dhe femra duhet të paguhet njësoj për punë të njëjtë.

6. AKTIVITETET KYÇE

Në mënyrë që të ndihmohet arritja e synimeve brenda fushëveprimit të këtij Memorandumi, çdo Nënshkrues në konsultim me partnerët relevant social duhet të diskutojë qasjen se si ti adresojë më tutje çështjet brenda dimensionit social. Kjo qasje duhet të ketë parasysh “acquis communautaire” ekzistuese të Evropës.

Konstatimet dhe aktivitetet e përshtatshme për të ardhmen duhet të përmbledhen në formën e planeve sociale të veprimit për të adresuar çështjet e cekura në seksionet e mësipërme të këtij Memorandumi. Planet sociale duhet të përpilohen në bashkëpunim të ngushtë me partet social.

7. MBËSHTETJA FINANCIARE

Nënshkruesit duhet të synojnë në shfrytëzimin optimal të çfarëdo burimi në dispozicion të tyre dhe çfarëdo fondi relevant të Komunitetit për të financuar objektivat e këtij memorandumi, pra financimin për pasojat ekonomike e sociale të ristrukturimit, kudo që kërkesat për një përdorim të tillë përmbushen.

Nënshkruesit ftojnë mbështetjen financiare të Komisionit Evropian dhe të Komunitetit të Donatorëve për aktivitete brenda fushëveprimit të këtij Memorandumi.

8. ROLI I KOMISIONIT EVROPIAN

Si Udhëheqës i Grupit të Donatorëve, i përkushtuar për realizimin e reformave në sektorin e energjisë, Komisioni do të përpiqet të sigurojë nga donatorët asistencë teknike dhe financiare për operimin e këtij Memorandumi.

9. FORUMI SOCIAL

Palët pajtohen të vlerësojnë nevojën për një Forum Social për konsiderimin e ndikimeve sociale të reformës së tregut të energjisë dhe, nëse vlerësohet pozitivisht, të arrihet kjo përvonesë. Vlerësimi duhet të bëhet në formë të një raporti për Ministerialin e Komunitetit

të Energjisë sa më shpejtë që të jetë e mundur, dhe Komisionit i kërkohet që të ndihmojë në këtë aspekt.

Bere ne Vjene, ne ditën e tetëmbëdhjete te tetorit te vitit dymijeshtatë.

Për Republikën e Shqipërisë

Për Bosnjën dhe Hercegovinën

Për Republikën e Kroacisë

Për ish Republikën Jugosllave te Maqedonisë

Për Republikën e Malit të Zi

Për Republikën e Serbisë

Për Misionin e Përkohshëm te Administratës se Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) në pajtim me Rezolutën 1244 te Këshillit te Sigurimit te Kombeve te Bashkuara

Për Komunitetin Evropian